

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor the Turqinë (Instrumenti Horizontal II) është programi mikëpritës i Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës

Kjo është faza e dytë e nismës për bashkëpunim të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në ndihmë të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës\*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Turqisë për përbushjen e standardeve të Këshillit të Evropës dhe *acquis* të Bashkimit Evropian në kuadrin e procesit të zgjerimit.

Kjo fazë mbështetet te rezultatet e fazës së parë, e cila u zhvillua nga viti 2016 deri në vitin 2019 në fusha më të gjera tematike, duke përfshirë: garantimin e drejtësisë; luftën kundër krimit ekonomik; luftën kundër diskriminimit si dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cënueshme (duke përfshirë LGBTI, pakicat dhe romët), si dhe lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias.

Instrumenti Horizontal II i mbështet përfutuesit e programit përmes një gasjeje të dyfishtë plotësuese:

- ▶ Bashkëpunimit teknik përshtatur sipas vendit, për arritjen e një përbushjeje më të madhe të standardeve evropiane, dhe
- ▶ Ofrimit të këshillimit dhe ekspertizës së posaçme si përgjigje ndaj kërkesave për analiza legjislative dhe asistencë lidhur me to përmes Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës (MKE).

\* Ky përcaktim nuk përbën asnjë parajgjykim ndaj qëndrimit lidhur me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së dhe me Opininionin e GjNK-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.



## ÇFARË ËSHTË MEKANIZMI I KOORDINIMIT TË EKSPERTIZËS?

— Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës (MKE) është një mjet për ofrimin e ekspertizës legjislative dhe këshillimit në nivel politikash nga Këshilli i Evropës, si përgjigje ndaj kërkesave specifike. Ai është pjesë e programit për bashkëpunim të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II (më poshtë Instrumenti Horizontal II).

## CILI ËSHTË OBJEKTI I MKE-SË?

— Nga ana gjeografike, MKE-ja mbulon Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kosovën\*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Turqinë.

— Objekti i punës së këtij mekanizmi përfshin ofrimin e këshillimit nga ekspertët për çështje legjislative dhe çështje politikash, duke përfshirë edhe vlerësimin e harmonizimit të legjislacionit dhe/ose dokumenteve politike me standardet e Këshillit të Evropës në këto fusha:

- ▶ garantimi i drejtësisë;
- ▶ lufta kundër krimit ekonomik;
- ▶ anti-diskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cënueshme;
- ▶ liria e shtypit dhe e medias;
- ▶ çështje kushtetuese, të cilat janë pjesë e fushës së kompetencës së Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (i njohur gjerësisht si Komisioni i Venecias).

## KUSH MUND TË BËJË KËRKESA NË KUADRIN E MKE-SË?

— Kërkesa për opinion të ekspertëve në kuadrin e MKE-së mund të bëhen nga ministër (dhe anëtarë të tjerë të qeverisë) ose nga kryetarët e parlamenteve të vendeve përfutuese.

— Përveç kësaj, sidomos për çështje që janë pjesë e kompetencës së Komisionit të Venecias, si Bashkimi Evropian, edhe organet e Këshillit të Evropës (d.m.th. Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale), mund të paraqesin kërkesa për asistencë nga MKE-ja. Gjithashtu, kërkesa për kontribute *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias mund të bëhen edhe nga gjykatat kushtetuese.

## SI FORMULOHEN KËRKESAT DHE SI TRAJTOHEN ATO?

— Kërkesat mund t'i drejtohen me shkrim, me postë ose me faks, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Marija Pejčinović Burić. Kërkesat që kanë të bëjnë me ekspertizën e Komisionit të Venecias mund t'i drejtohen edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë Presidentit të Komisionit të Venecias, Gianni Buquicchio.

— Kërkesat preferohet të jenë sa më të hollësishme, duke përfshirë emrin dhe llojin e legjislacionit apo politikës për të cilën kërkohet ekspertizë, shkaku i kërkesës për ekspertizë apo për ndryshimin e legjislacionit apo politikës përkatëse, si dhe periudha kohore kur parashikohet të miratohet legjislacioni i ri apo dokumentet e reja politike (ose ndryshimet në legjislacionin ekzistues apo në dokumentet ekzistuese të politikave), pas dhënies së ekspertizës së kërkuar.

— Me marrjen e kërkesave, ato trajtohen nga njësitë përkatëse të Këshillit të Evropës. Ndonëse Këshilli i Evropës synon që ta ofrojë ekspertizën e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, afati i saktë kohor përcaktohet përmes konsultimeve me autoritetet kërkuuese.



## CILAT JANË KRITERET PËR PRANIMIN E NJË KËRKESË?

— Kërkesat e drejtuara MKE-së duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme. Kërkesa:

- ▶ duhet të bëhet nga një anëtar i qeverisë ose nga kryetari i parlamentit ose, nëse kërkesa ka të bëjë me një opinion *amicus curiae*, nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës\*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë ose Turqisë (ose, në rast se kërkesa do të kishte të bënte me ekspertizën e Komisionit të Venecias, kjo kërkesë mund të bëhet edhe nga Bashkimi Evropian ose Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare ose Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale);
- ▶ duhet të jetë objekt i ekspertizës së Këshillit të Evropës;
- ▶ duhet të jetë brenda këtyre fushave tematike: garantimi i drejtësisë; lufta kundër krimit ekonomik; anti-diskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cënueshme; liria e shprehjes dhe e medias; çështje kushtetuese që janë objekt i kompetencës së Komisionit të Venecias;
- ▶ nuk mund të plotësohet brenda formatit të një prej aktiviteteve ekzistuese të komponentit të bashkëpunimit teknik të Instrumentit Horizontal.

## KU DUHET TË DREJTOHEN KËRKESAT?

— Kërkesat për MKE-në mund të dërgohen me postë ose me faks në adresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës:

- ▶ Marija Pejčinović Burić  
Secretary General of the Council of Europe  
Council of Europe  
F-67075 Strasbourg Cedex, France – Fax: + 33 3 88 41 27 99  
Website: [www.coe.int/en/web/secretary-general/private-office](http://www.coe.int/en/web/secretary-general/private-office)

— Kërkesat për MKE-në, të cilat kanë të bëjnë me ekspertizën e Komisionit të Venecias, mund t'i dërgohen edhe me postë, e-mail ose me faks Presidentit të Komisionit të Venecias:

- ▶ Gianni Buquicchio  
President of the Venice Commission  
Council of Europe  
67075 Strasbourg Cedex, France – Fax: +33 3 88 41 37 38  
e-mail: [venice@coe.int](mailto:venice@coe.int)



## Shembuj të mbështetjes së ofruar në kuadrin e MKE-së (2016- 2019)

- ▶ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë kërkoi një **opinion amicus curiae në lidhje me Ligjin për Trajtimin e Pronave dhe Finalizimin e Procesit të Kompensimit të Pronave**. Ky opinion u dha nga Komisioni i Venecias më 14-15 tetor 2016, duke hapur rrugën miratimit dhe zbatimit të këtij legjislacioni kyç.
- ▶ Në Bosnje-Hercegovinë, ekspertiza ligjore është ofruar nga Këshilli i Evropës në prill të vitit 2018 lidhur me **Ligjin për të Drejtat e Viktimave të Torturës**, me kërkesë të Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve.
- ▶ Në Malin e Zi është ofruar një opinion për dispozitat që kishin të bënin me të drejtat e njeriut në **Projektligjin për të Huajt**. Ky Ligj, i cili është miratuar në shkurt të vitit 2018, garanton një ekuilibër më të mirë mes dispozitave për sigurinë dhe dispozitave që u garantojnë të drejtat e njeriut personave në migrim, në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- ▶ Ministria e Punës dhe Politikave Sociale të Maqedonisë së Veriut kërkoi mbështetje për hartimin e **Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi**. Pas marrjes së opinionit të Komisionit të Venecias të miratuar në seancën e tij plenare të 16-17 marsit 2018 (CDL-AD(2018)001), ky ligj u miratua në mars të vitit 2019, duke futur në legjislacion edhe identitetin gjinor si shkak të diskriminimit.
- ▶ Gjithashtu, është ofruar mbështetje për përmirësimin e projekt-ndryshimeve në **dispozitat kushtetuese në lidhje me gjyqësorin në Serbi**. Komisioni i Venecias miratoi një opinion në qershor të vitit 2018 (CDL-AD(2018)011), i cili ngriti disa çështje për adresim. Në një seancë plenare në tetor të 2018-ës, Komisioni i Venecias konstatoi se qeveria e Serbisë i kishte zbatuar rekomandimet e tij në versionin e rishikuar të Kushtetutës.

### PËR MË SHUMË INFORMACION

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>  
f [jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)  
@CoE\_EU\_HF

### KONTAKT

Horizontal Facility Co-ordination Team  
Office of the Directorate General of Programmes  
Council of Europe  
Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France  
E-mail: [Horizontal.Facility@coe.int](mailto:Horizontal.Facility@coe.int)

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që i mundëson Përfutuesve të përmbushin agjendën e reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor, demokracisë si dhe të respektojnë standardet evropiane, duke u përfshirë kur është e mundur në kornizën e proceseve të zgjerimit të BE-së. Ky program 3-vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Turqi dhe Kosovë\*, si dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës që prej muajit Maj 2019.

\*Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës

Garantimin e drejtësisë  
Luftën kundër krimit ekonomik  
Luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme  
Lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias  
Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës

# INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2019-2022

MEKANIZMI I KOORDINIMIT TË EKSPERTIZËS – PËRMBLEDHJE

PREMS 176419 - Photos: Shutterstock